

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,
SEZONI 2023/2024
(java e dhjetë, deri më 10.03.2024)

TË DHËNA JAVORE


Gjatë javës së dhjetë të vitit 2024 (nga 04-10.03.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 427 (I=23,3/100.000) të prekur nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 33,4% më pak krahasuar me javën e kaluar (n=641).

Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit ta kaluar (n=464) është regjistruar një rënie prej 8,0%, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit (n=1.376) është regjistruar një rënie prej 69% . (Grafiku 1)

Gjatë javës së dhjetë të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV kanë arritur 29 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19. 1 rast ka rezultuar pozitiv e Influenza B/Victoria. Janë regjistruar 2 raste me COVID-19.

Incidenca e raportuar është nën kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit (I=30,6/100.000) (Grafiku 1).

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike të pritur 2010-2023, sezoni 2022/2023 dhe sezoni 2023/2024




Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 282 persona, nga 0-4 vjet –35, tek grupmosha nga 5-14 – 83 dhe tek grupmosha mbi 65 vjet 27 persona. Incidencë më e lartë (38,6/100.000) është regjistruar tek grupmosha nga 5-14 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë raportuar nga 19 QShP/NjR: Kavadar - 71, Shkup – 69, Gostivar – 67, Strumicë – 61, ndërsa në të tjerat numri i rasteve të raportuara është më pak se 50.

Nga njësitë e raportimit që kanë raportuar raste gjatë kësaj jave në 12 është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, në 6 është regjistruar aktivitet sezonal i virusit të gripit, në 1 mesatar (*Hartogrami 1*).

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, jave e dhjetë 2024



Gjatë kësaj jave është regjistruar 1 rast i vdekjes si pasojë e gripit, person në moshë mbi 65 vjet nga Shtipi, që ka qenë i shtruar në KSIGJF, pa komorbiditete dhe që nuk kanë qenë të vaksinuar kundër gripit sezonal. Tek ai është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09.


MBIKËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE - Të dhëna kumulative

Gjatë sezonit 2023/2024 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 13.809 (I=751,8/100.000).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=9.324) numri i rasteve të regjistruara është rritur për 48,1%, ndërsa krahasuar me modelin e 13 viteve të fundit (n=19.066) është regjistruar një rënie prej 27,6%.


Raste janë raportuar nga gjithsej 31 QShP/NjR. Numër më i madh i të sëmurëve (n=1.854) është regjistruar në QSHP Shkup ndërsa incidencë më e lartë kumulative (6.774,0/100.000) është regjistruar në Dibër.

Grafiku 2. Shpërndarja sipas QShP/NjR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2023/2024



Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar në grupmoshën e cila përfshin pjesën më të madhe të popullatës (15-64 vjet) – 8.025 (58,1%), ndërsa incidencë më e lartë (1.774,7/100.000) është regjistruar tek fëmijët në moshë nga 0-4 vjet (n=1.713).


Grafiku 3. Shpërndarja sipas grupmoshës dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2023/2024



Shpërndarja e rasteve të gripit sipas muajve:

- tetor – 196 raste ose 1,4%
- nëntor – 268 raste ose 1,9%
- dhjetor – 829 raste ose 6,0%
- janar – 5.176 raste ose 41,4%
- shkurt – 6.373 raste ose 46,2%
- mars - 427 raste ose 3,1%

Grafiku 4. Shpërndarja sipas muajve, sezoni 2023/2024



Deri më tani gjatë këtij sezoni janë regjistruar 14 raste të vdekjes si pasojë e gripit, nga Shtipi, Velesi, Kumanova, Negotina, Gostivari, Demir Hisari dhe Shkupi, 7 të grupmohës nga 15-64 dhe 7 mbi 65 vjet, të gjithë të hospitalizuar dhe të pavaksinuar kundër gripit sezonal, 12 prej tyre me komorbiditete. Tek 11 raste është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, tek 2 Influenza A – e pasubtipizuar, ndërsa tek 1 Influenza B/Victoria.

МБИКËQYRJA VIRUSOLOGJIKE (mbikëqyrja rutinore) – Të dhëna kumulative

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e dhjetë, pranë laboratorit të virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 888 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për prani të virusit të gripit, nga mbikëqyrja rutinore.

Të gjitha materialet e pranuar janë testuar për prani të virusit të gripit dhe SARS-CoV-2, me ç'rast janë detektuar 141 raste pozitive, 118 Influenza A(H1)pdm09, 12 Influenza A(H3) dhe 9 Influenza A – e pasubtipizuar, 1 Influenza B/Victoria dhe 1 Influenza B –linjë e papërcaktuar.

Janë regjistruar edhe 20 raste pozitive me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar 29 raste me Virus Respirator Sincial (RSV).

МБИКËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes ndaj gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohet informacion më i detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për implementimin në kohë të masave preventive.

Definicioni për rast SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është e harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja që nga viti 2014.

Në vendet sentinel gjatë javës së dhjetë janë raportuar gjithsej 23 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga Klinika e sëmundjeve infektive dhe gjendjeve febrile - Shkup (n=8; 34,8%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=7; 30,4%) janë raportuar në mesin e grupmoshës 5-14 dhe 15-29 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 165, me 1 rast në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 13,9% i përkasin SARI. Ngarkesë më e madhe prej 50,0% vihet re tek grupmosha 15-29 vjet.

Kumulativisht gjatë javës së dhjetë për analizë laboratorike kanë arritur 21 materiale nga rastet e raportuara SARI, paralelisht të testuara edhe për virusin e gripit, virusin sincicial respirator edhe për COVID-19. Në mostrat e analizuara në nga një mostër është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, Influenza A(H3) dhe Influenza B – linjë e papërcaktuar, ndërsa në 4 - Influenza B/Victoria. Në 1 është vërtetuar COVID-19, 13 mostra janë testuar për virusin sincicial respirator, që të gjitha kanë rezultuar negative.

Gjatë kësaj jave është raportuar 1 rast i vdekjes nga KSIGJF, në moshë mbi 65 vjet, tek i cili është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, pa komorbiditete.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 957 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (n=312; 32,6%) janë raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve Shkup. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=431; 45,0%).

Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 4.541, nga të cilët 48 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 21,1% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e madhe prej 40,3% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Janë regjistruar edhe 14 raste të vdekjes, që i përkasin grupmoshës 30-64 vjet dhe mbi 65 vjet, me komorbiditete me Influenza A(H1)pdm09, Influenza A e pasubtipizuar dhe Influenza B/Victoria, ndërsa një me SARS-CoV-2.

Kumulativisht, për testim laboratorik janë dorëzuar 560 materiale nga rastet e raportuara SARI. Në 79 mostra është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, në 18 Influenza A(H3), 4 Influenza A e pasubtipizuar dhe në 8 Influenza B/Victoria dhe në 2 Influenza B e papërcaktuar. Janë regjistruar 35 raste pozitive me COVID-19.

Nga mostrat SARI, 408 u testuan për virusin respirator sincicial (RSV), nga të cilët 115 rezultuan pozitivë.

Adenovirusi u zbulua në 5 mostra dhe Enterovirus në një. Në 2 mostra është vërtetuar prania e njëkohshme e virusit sincicial respirator (RSV) dhe adenovirusit. Në 3 mostra është vërtetuar prania e njëkohshme e Influenza A(H1)pdm09 dhe SARS-CoV-2.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e tetë të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë në ISHP kanë arritur 1.450 materiale, që janë testuar për prani të virusit të influencës dhe SARS-CoV-2.


Janë zbuluar 252 raste me Influenza:

- Influenza A – 240 (95,2%)
 - Influenza A(H1)pdm09 – 197 (82,1%)
 - Influenza A(H3) – 30 (12,5%)

- Influenza A – e pasubtipizuar - 13 (5,4%)
- Influenza B – 12 (4,8%)
 - Influenza B/Victoria – 9 (75,0%)
 - Influenza B – e papërcaktuar – 3 (25,0%)

Janë regjistruar 55 raste pozitive me SARS-CoV-2, 144 me (RSV) dhe 13 me viruse të tjerë respiratorë. Nga rastet me Influenza dhe COVID-19, tek 6 raste është vërtetuar infeksion i dyfishtë (“flurona”).

Grafiku 5. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes së rasteve pozitive me grip, RMV, 2023/2024



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një rënie e dukshme numrit të sëmundjeve të ngjashme me gripin, i cili është në kuadër të aktivitetin jashtë-sezonal. Rezultatet e marra nga mbikëqyrja virologjike e gripit tregojnë përhapje rajonale të virusit të influencës. Sipas këtyre të dhënave, Republika e Maqedonisë së Veriut ka një përhapje rajonale gjeografike dhe intensitet të ulët të virusit të gripit.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- ❖ Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- ❖ Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- ❖ Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- ❖ Gratë shtatzëna dhe
- ❖ Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për shëndetësi elektronike që nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti janë vaknuar gjithsej 59.170 persona nga kategoritë e rrezikuara të qytetarëve.

4.500 vakcina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale deri më tani janë vaksinuar gjithsej 2.618 persona.

Deri në javën e tetë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 61.788 persona me vaksinat falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary) të publikuar në javën e nëntë të vitit 2024 për aktivitetin e virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksionet akute të frymëmarrjes (ARI) janë rritur mbi nivelet bazë në 19 nga 28 vendet dhe zonat e Rajonit Evropian të OBSH-së.
- Aktiviteti i gripit mbetet i lartë, aktiviteti i COVID-19 ka filluar të bjerë këto 2 muajt e fundit.
- Pranimet në spital (SARI) me grip dhe RSV në 2 muajt e fundit kanë shënuar rënie.
- Zbulimet e vërtetuara të infeksionit me virusin e influencës nga ISHP sentinel për javën e kaluar ishin Influenza 49% A(H1)pdm09, 49% A(H3) dhe 2% B/Victoria.
- Në të gjithë rajonin, nga mostrat e pacientëve nga mbikëqyrja SARI:
- Shkalla e zbulimit të virusit të gripit është 16% krahasuar me 19% një javë më parë.
- Në mostrat SARI janë regjistruar 294 raste me infeksion me virusine gripit.

- SARS-CoV-2 është në 3% krahasuar me 4% javën e kaluar.
- RSV ishte 9% krahasuar me 11% në javën e kaluar

Nga vendet që raportojnë për intensitetin e gripit, 4 vende ka raportuar për intensitet të lartë, 16 kanë raportuar intensitet mesatar, 10 të ulët dhe 5 intensitet bazë.

Nga vendet që raportojnë për shpërndarjen gjeografike, 25 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë, 5 - rajonale, 5 - sporadike, dhe 1 vend ka raportuar që nuk ka aktivitet të virusit të gripit.

OBSH publikoi rekomandimet për vaksinat kundër gripit sezonal për përdorim në sezonin 2024-2025 në hemisferën veriore. Rekomandohet që vaksina trivalente të përmbajë:

Vaksina të bazuara në vezë

- A/Victoria/4897/2022 (H1N1)pdm09-like virus;
- A/Thailand/8/2022 (H3N2)-like virus; dhe
- B/Austria/1359417/2021 (B/Victoria lineage)-like virus.

Vaksina të bazuara në qeliza ose të rikombinuara

- A/Wisconsin/67/2022 (H1N1)pdm09-like virus;
- A/Massachusetts/18/2022 (H3N2)-like virus; dhe
- B/Austria/1359417/2021 (B/Victoria lineage)-like virus.

Komponenti i linjës B/Yamagata duhet të përjashtohet pasi nuk është më i nevojshëm, por në vendet ku vaksinat katërvalente ende administrohen, përbërësi i linjës B/Yamagata duhet të mbetet i pandryshuar - B/Phuket/3073/2013 (Linja B/Yamagata)- si virusi.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive
Instituti i Shëndetit Publik